

Si të merrni ndihmë me pagimin e faturave të spitalit

Nuvance Health është e përkushtuar të ndihmojë pacientët me faturat e spitalit.

Kopje të rregullores për asistencën financiare të Nuvance Health dhe të aplikimeve për asistencë financiare mund të gjenden në njësinë e biznesit, departamentin e regjistrimit, departamentin e urgjencës dhe në Zyrën e Marrëdhënieve me Komunitetin. Aplikimet janë të disponueshme në anglisht, spanjisht, portugalisht dhe në gjuhë të tjera që fliten në komunitetet tona.

Spitalet e Nuvance Health (Danbury, New Milford, Norwalk dhe Sharon Hospitals në CT, dhe Vassar Brothers Medical Center, Northern Dutchess Hospital dhe Putnam Hospital Center në NY) do të marrin një vendim për pranueshmërinë tuaj për asistencë financiare sa më shpejt të jetë e mundur pas marrjes së aplikimit të plotësuar për asistencë. Do të merrni një njoftim me shkrim për rezultatin e rastit tuaj.

Në rast se aplikimi juaj refuzohet, ne do t'ju japim arsyen për refuzimin dhe do t'ju japim informacion se si ta apeloni vendimin. Në rast se zgjidhni të apeloni, ne do të punojmë me ju për t'u siguruar që të marrim parasysh të gjitha faktet përkatëse kur të marrim vendimin përfundimtar.



24 Hospital Avenue
Danbury, CT 06810

www.nuvancehealth.org/financialassistance



46019_FAP_ENGLISH_TRI_160824

Asistenca financiare

Kualifikimi për asistencë me faturat tuaja mjekësore



A jeni i pasiguruar ose a keni probleme me pagimin e faturave të spitalit?

Ne mund t'ju ndihmojmë. Nëse po përballeni me vështirësi financiare personale për shkak se nuk keni sigurim ose për shkak të kostove mjekësore të jashtëzakonshme, mund të pranoheni të merrni asistencë financiare për të mbuluar një pjesë të kostove ose të gjitha kostot për shërbimet spitalore, ambulatore dhe për shërbimet e urgjencës të ofruara nga **spitalet e Nuvance Health (Danbury, New Milford, Norwalk dhe Sharon Hospitals në Konektikat, dhe Vassar Brothers Medical Center, Northern Dutchess Hospital dhe Putnam Hospital Center në Nju-Jork)**

Ju lutem vini re:

Spitalet e Nuvance Health do të ofrojnë gjithnjë trajtim mjekësor emergjent pavarësisht nga aftësia juaj për të paguar.

Kriteret

Spitalet tona do t'ju ofrojnë asistencë financiare në rast se përmbushen **një ose më shumë** prej kushteve të mëposhtme:

- Ju keni një ose më shumë shuma të papaguara për spitalet e Nuvance Health ose për ofruar të tjerë.
- Ju keni aplikuar dhe ju është refuzuar pranimi për ndonjë mbulim mjekësor ose kujdesi shëndetësor që ofrohet nën programet e Medicaid ose programet shtetërore, për shkak se nuk keni përmbushur kërkesat për të ardhurat ose për pranueshmërinë.

- Ju nuk kualifikoheni për mbulim të shërbimeve spitalore nga asnjë program tjetër sigurimi shëndetësor ose program sigurimi për aksidentet (duke përfshirë kompensimin e punëtorëve, përgjegjësinë e palëve të treta, sigurimin e mjeteve motorike).
- Të ardhurat tuaja familjare janë në ose nën 400% të udhëzuesit federal për të ardhurat (bazuar në udhëzuesin federal vjetor për varfërinë).

Nëse të ardhurat tuaja familjare janë 400% të udhëzuesit federal për varfërinë dhe po përballeni me fatura të mëdha mjekësore, përsëri mund të pranoheni për zbritje në tarifat e spitalit.

Si mund të marr ndihmë?

Konsulentët tanë financiarë të trajnuar janë në dispozicion t'ju ndihmojnë për të përcaktuar nëse kualifikoheni për asistencë financiare. Konsulentët tanë financiarë mund t'ju ndihmojnë për të aplikuar për asistencë financiare nga programet qeveritare, dhe me përcaktimin e marrëveshjeve për pagesën. Ata mund të miratojnë gjithashtu disa rregullime në detyrimin tuaj, duke u bazuar në nevojën financiare dhe/ose vështirësitë mjekësore. **Asnjë pacient që kualifikohet për asistencë financiare nga Nuvance Health, nuk do të tarifohet më shumë se shumata e faturuara përgjithësisht (AGB) për shërbim urgjence ose për shërbimin e nevojshëm nga ana mjekësore.**

Ju lutem na kontaktoni

Nëse keni pyetje ose nëse doni të merrni një kopje FALAS të rregullores për asistencën financiare dhe një aplikim për asistencën financiare me postë, email, ose në kopje të shtypur, telefononi ose vizitoni Shërbimet Financiare për Pacientin në:

- Danbury Hospital: (203) 739-7773
24 Hospital Avenue, Danbury, CT 06810 (Orari, E hënë-E premte, 9 a.m. – 4 p.m.)
- Norwalk Hospital: (203) 852-1579
34 Maple Street, Norwalk, CT 06856 (Orari, E hënë-E premte, 9 a.m. – 4 p.m.)
- New Milford Hospital: (860) 210-5427,
21 Elm Street, New Milford, CT 06776
- Sharon Hospital: (860) 364-4275
50 Hospital Hill Road, Sharon, CT 06069 (Orari, E hënë-E premte, 8 a.m. – 4:30 p.m.)
- Vassar Brothers Medical Center: (845) 431-5693, 45 Reade Place,
Poughkeepsie, NY 12601 (Orari, E hënë-E premte, 8:30 a.m. – 5 p.m.)
- Putnam Hospital Center:
(845) 279-5711, x4789, 670 Stoneleigh Avenue, Carmel Hamlet,
NY 10512 (Orari, E hënë-E premte, 7:30 a.m. – 4 p.m.)
- Northern Dutchess Hospital: (845) 871-4347, 6511 Spring Brook Avenue,
Rhinebeck, NY 12572 (Orari, E hënë-E premte, 8 a.m. – 4 p.m.)